

Hekurlidhës : kërkojmë rregullarizimin !

Mjaft me shfrytëzimin dhe pasigurinë

Sindikata SIT i fton të gjithë hekurlidhësit e Gjenevës të marrin pjesë në Kuvendin e përgjithshëm të hënën, më 27 tetor 2025, në orën 18:00 – rue des chaudronniers 16, 1211 Genève 3

Prej më shumë se 20 vitesh, sindikata SIT mbron me këmbëngulje kushtet e punës së hekurlidhësve, pothuajse të gjithë pa dokumente. Një mbrojtje si në plan individual ashtu edhe kolektiv, por edhe përmes veprimeve politike apo denoncimeve publike.

Ky angazhim ka filluar të japë fryte. Nën presionin sindikal, kompanitë e mëdha që nënkontraktojnë punimet e armatimit të betonit duke ulur çmimet po kuptojnë se mund të mbahen përgjegjëse për këtë skllavëri të kohëve moderne. Prandaj, ato më në fund kanë pranuar të hyjnë në negociata me sindikatat për të pastruar sektorin ! Shumë mirë ! Por për t'u mundësuar punëtorëve të mbrojnë siç duhet të drejtat e tyre kundër praktikave mashtruese të kompanive, falimentimeve zinxhirore, punës me thirrje të paligjshme dhe padrejtësisë sociale që i detyron të jetojnë me paga prej 2000 frangash në muaj pa asnjë mbrojtje sociale, është thelbësore që ata të kenë një status të rregullt.

Sot, ndërsa qindra hekurlidhës janë shfrytëzuar, dëbuar dhe trajtuar me dhunë nga sistemi mafioz që është rrënjësuar në këtë sektor, të parët prej tyre, që kanë mbërritur tashmë në moshën 60 vjeçare, po privohen nga e drejta e pensionit të parakohshëm, vetëm për shkak se punëdhënësit nuk i kanë deklaruar tek sigurimet sociale. Skandoloze!

Kjo situatë shoqërisht e papranueshme duhet të marrë fund : autoritetet e Gjenevës duhet të gjejnë një zgjidhje për rregullarizimin e të gjithë hekurlidhësve. Por pa presion kolektiv, Shteti nuk do të veproj. Prandaj duhet të organizohemi që tani për të kërkuar:

NJË PUNË = NJË LEJE QENDRIMI

Sepse pa hekurlidhësit, i gjithë sektori i ndërtimit do të paralizohet.

JO DËNIMIT TË TREFISHTË : të shfrytëzuar, të dëbuar dhe tani pa të drejtë për pension të parakohshëm

MOS LEJOJMË QË TË NA IK TRENI ! TË MOBILIZOHEMI, TË VEPROJMË!

« Ai që lufton mund të humbasë, por ai që nuk lufton ka humbur tashmë. »